



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 182

Tiranë – E hënë, 17 gusht 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme dhe i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 159, datë 31.7.2026	Për bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe autoriteteve përgjegjëse të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, për përcaktimin e procedurave për miratimin e lejes unike..... 18337
Udhëzim i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 8, datë 6.8.2026	Për përcaktimin e kriterëve, për përpilimin e listave, mënyrën e hartimit të skedave përshkuese për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore, objekt verifikimi të interesit kulturor, dhe dërgimit të tyre 18339
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 163, datë 14.8.2026	Për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin..... 18347
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 806, datë 7.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës..... 18347
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 816, datë 11.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Hungarisë..... 18348
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 817, datë 11.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë..... 18351
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 818, datë 11.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës..... 18352
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 819, datë 11.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar..... 18354

Urdhër i ministrit të Bujqësisë
dhe Zhvillimit Rural nr. 821,
datë 11.8.2026

Për miratimin e rregullores “Për kërkesat e shëndetit të kafshëve,
certifikimit dhe njoftimit për lëvizjet e produkteve me origjinë
shtazore nga kafshët tokësore” 18357

Urdhër i ministrit të Bujqësisë
dhe Zhvillimit Rural nr. 822,
datë 12.8.2026

Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në
shtetin e Spanjës..... 18359

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 159, datë 31.7.2026****PËR BASHKËPUNIMIN
NDËRINSTITUCIONAL NDËRMJET
AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË
BRENDSHME DHE AUTORITETEVE
PËRGJEGJËSE TË MINISTRISË SË
EKONOMISË DHE INOVACIONIT, PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E LEJES UNIKE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 12, të nenit 74, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e procedurave të bashkëpunimit të autoriteteve përgjegjëse për trajtimin e të huajve me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit

UDHËZOJNË:

1. Bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse që mbulojnë çështjet e kufirit dhe migracionit, dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse që mbulojnë çështjet e punësimit të të huajve, mbi zbatimin e procedurave të miratimit të lejes unike, për kategoritë e të huajve që kërkojnë miratim për punësim.

2. Kërkesa për pajisje me leje unike ose për ripërtëritjen e saj, bëhet nëpërmjet platformës *e-albania*, drejtuar drejtorisë së kufirit dhe migracionit në rajonin ku kryhet aktiviteti.

3. Për kategoritë e të huajve, punëmarrës, të vetëpunësuar, punonjës ndërkufitarë, për formim profesional, punëtorët e shtëpisë, punonjës stinorë, të transferuar brenda ndërmarrjes, punonjës me kualifikim të lartë, vullnetarë, sportistë dhe shërbime kontraktuale, kërkesa shqyrtohet fillimisht nga autoriteti përgjegjës qendror/rajonal i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), që mbulon territorin ku i huaji kryen aktivitetin.

4. Për shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe anëtarët e familjes së tyre, dhe shtetas të zonës Shengen, që nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, shtetasit e njërit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-

Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, kërkesa trajtohet vetëm nga struktura vendore e kufirit dhe migracionit, ndërsa AKPA-ja i siguron të dhënat për këtë kategori të huajsh të punësuar, nëpërmjet sistemit elektronik.

5. Autoriteti përgjegjës qendror/rajonal i AKPA-së shprehet në sistemin elektronik *online*, me miratim paraprak/aprovim/kërkesë për plotësim dokumentacioni apo refuzim të kërkesës për miratim punësimi, brenda 1 (një) dite pune pas vlerësimit të aplikimit në sistemin e shërbimeve të punësimit, kontratës së punës/ofertës së punës (sipas formatit standard në shtojcën 1 dhe/ose dokumenteve të tjera të nevojshme).

6. Autoriteti përgjegjës qendror/rajonal i AKPA-së, miraton kërkesën për punësim nëse janë plotësuar kriteret e pikës 6, të nenit 74, të ligjit “Për të huajt”, të ndryshuar, kriteret dhe dokumentacionin sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe duke u bazuar në dokumentacionin e siguruar nëpërmjet konsultimit me sisteme të tjera informatike.

7. Për ripërtëritjen e lejes unike, në rastet kur kërkohet miratimi për punësim, ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e kërkesës për miratim për punësim për herë të parë, me përjashtim të shpalljes së vendit të lirë të punës.

8. Në rast se, miratimi për punësimin e një të huaji revokohet, autoriteti përgjegjës qendror/rajonal i AKPA-së, shprehet në sistemin elektronik *online* për revokimin e miratimit për punësim.

9. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin dhe autoriteti përgjegjës qendror/rajonal i AKPA-së, shkëmbejnë informacione për rastet kur ka ndryshim të kushteve të punësimit apo kur AKPA-ja refuzon të japë miratimin për punësimin e një të huaji.

10. Verifikimi i dokumentacionit të paraqitur *online* për miratimin e lejes unike, bëhet nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin.

11. Drejtori i përgjithshëm i AKPA-së përcakton personat përgjegjës për aprovimin apo refuzimin e kërkesës në strukturën qendrore/rajonale.

12. Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, datë 11.1.2023, “Mbi



bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse të Ministrisë së Brendshme dhe autoriteteve përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për përcaktimin e procedurave për miratimin e lejes unike”, shfuqizohet.

13. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

MINISTËR I EKONOMISË DHE
INOACIONIT
Delina Ibrahimaj

SHTOJCA 1

OFERTË PUNËSIMI/JOB OFFER

1. Informacion rreth punëmarrësit/*Employee Information*

1.1 Emri/*First Name*

1.2 Mbiemri/*Last Name*

1.3 Data e lindjes/*Date of Birth*

1.4 Gjinia/*Gender*

1.5 Numri i pasaportës/*Passport Number*

1.6 Data e skadimit të pasaportës/*Passport Expiry Date*

1.7 Shtetësia/*Nationality*

1.8 Shteti i vendbanimit aktual/*Country of Current Residence*

1.9 Email/*Email*

1.10 Telefoni/*Phone Number*

2. Detajet e punëdhënësit/*Employer Details*

2.1 NIPT/*Tax Identification Number (NIPT)*

2.2 Emri i subjektit/*Company Name*

2.3 Sektori i aktivitetit/*Economic Sector*

2.4 Bashkia/*Municipality*

2.5 Adresa/*Address*

2.6 Personi i kontaktit/*Contact Person*

2.7 Email/*Email*

2.8 Telefoni/*Phone Number*

3. Informacion mbi punësimin/*Employment Information*

3.1 Aplikim për herë të parë, rinovim i lejes ekzistuese apo ndryshim i punëdhënësit brenda

vendit? /*First-time application, renewal of an existing permit, or change of employer within the country?*

3.2 Regjistrimi i vendit të lirë të punës në zyrën e punës (për aplikim për herë të parë)/*Registration of the vacancy with the employment office (for first-time applications)*

3.3 Data e pritshme e fillimit të punës (për aplikim për herë të parë)/*Expected start date of employment (for first-time applications)*

3.3.1 Periudha e provës (nëse aplikohet)/*Probation period (if applicable)*

3.4 Data e regjistrimit në zyrën e punës (për rastet e rinovimit)/*Registration date with the employment office (for renewal cases)*

3.5 Lloji i kontratës së punës (me afat të pacaktuar me afat të caktuar)/*Type of Employment Contract (open-ended/fixed-term)*

3.5.1 Në rast se kontrata është me afat të caktuar, përcaktohet data e përfundimit/*If fixed-term, specify the end date*

3.6 Adresa kryesore e vendit të punës/*Main Workplace Address*

3.7 A kryhet puna në më shumë se një adresë/vend pune? Nëse po, ju lutemi specifikoni të gjitha adresat ku do të ushtrohet aktiviteti./*Will the work be performed at more than one work location/address? If yes, please specify all locations where the activity will be carried out.*

3.8 Pozicioni i punës/Profesioni/*Job Position/ Occupation*

3.9 Përshkrimi i detyrave/*Job Description*

3.10 Orët javore të punës/*Weekly Working Hours*

3.11 A kërkohet që punëmarrësi të punojë mbi 40 orë në javë? Nëse po, ju lutemi specifikoni numrin e pritshëm të orëve shtesë dhe shpërblimin/*Is the employee required to work more than 40 hours per week? If yes, please specify the expected number of overtime hours and remuneration/compensation.*

3.12 Ditët e pushimit/*Days of Rest*

3.13 Paga bruto mujore/*Gross Monthly Salary*

3.14 A do të kryhet puna gjatë intervalit kohor 22:00–06:00 (punë nate)? Nëse po, ju lutemi specifikoni mënyrën e shpërblimit/kompensimit të tyre./*Will the work be performed during the period 22:00–06:00 (night work)? If yes, please specify the applicable remuneration/compensation.*

3.15 Forma të tjera të shpërblimit/kompensimit (specifikohen, nëse ka)/*Other forms of compensation (specify if any)*



3.16 Data maksimale mujore e dhënies së pagës përmes bankës/Maximum monthly salary payment date through bank account

3.17 Akomodimi mbulohet nga punëdhënësi?/Accommodation provided by employer?

3.18 Punëdhënësi mbulon kostot e ushqimit?/Does the employer provide a food allowance?

3.19. Rekrutimi është kryer nga:/Recruitment has been carried out through: ☐ Vetë punëdhënësi/Employer; ☐ Agjenci punësimi e licencuar/Licensed employment agency

3.20. Nëse rekrutimi është kryer përmes një agjencie private punësimi, specifikoni emrin e agjencisë /If recruitment has been carried out through a private employment agency, specify the name of the agency:

3.21 Detaje të tjera mbi punësimin/Other Employment Details

4. Informacion mbi kualifikimet e punëmarrësit/Employee Qualifications

Unë, punëdhënësi _____, vetëdeklaroj se punëmarrësi i propozuar i ka aftësitë e nevojshme për ushtrimin e detyrës/I, the employer _____, hereby declare that the proposed employee has the necessary skills to perform the job.

4.1 Niveli më i lartë arsimor (nëse ka)/Highest level of education (if any)

4.2 Fusha e diplomimit (nëse ka)/Field of study (if any)

4.3 Shteti i diplomimit (nëse ka)/Country of graduation (if any)

4.4 Certifikata profesionale (nëse ka)/Professional certificates (if any)

4.5 Shteti i certifikimit (nëse ka)/Country of certification (if any)

4.6 A i nënshtrohet ushtrimi i profesionit një profesioni të rregulluar/të licencuar?/Is the profession regulated/licensed?

4.7 Gjuha(t) e kërkuara/Required Language(s)

4.8 Çdo kualifikim tjetër ose fakte të tjera relevante për pozicionin/Any other relevant qualifications or information

5. Hapësirë për informacione shtesë/Additional Information

Nënshkrimi i punëdhënësit/Employer Signature

Konfirmoj se i gjithë informacioni i dhënë në këtë formular korrespondon me përmbajtjen e kontratës së punës që do të lidhet ndërmjet palëve, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së

Shqipërisë/I confirm that all information provided in this form corresponds to the employment contract to be concluded between the parties, in accordance with the Labour Code of the Republic of Albania.

Konfirmoj se oferta e punës nuk përmban kushte më pak të favorshme se ato të punonjësve shqiptarë në të njëjtin pozicion/I confirm that the job offer does not contain less favorable conditions than those of Albanian employees in the same position.

Konfirmoj se punëmarrësi ka marrë një kopje në gjuhën angleze ose të përkthyer të ofertës së punësimit/I confirm that the employee has received a copy of the job offer in English or translated version of the job offer.

Konfirmoj se punëmarrësi nuk do të kryejë asnjë pagesë, tarifë apo kosto që lidhet me procesin e rekrutimit, ndërmjetësimit ose punësimit. Çdo kosto e lidhur me rekrutimin mbulohet nga punëdhënësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi./I confirm that the employee shall not be required to pay any fee, charge or cost related to the recruitment, placement or employment process. Any costs associated with recruitment shall be borne by the employer, in accordance with the applicable legislation.

Kjo ofertë është e vlefshme deri më datë/This offer is valid until:

Emër, mbiemër dhe nënshkrim elektronik i punëdhënësit/Name, surname and electronic signature of employer

UDHËZIM

Nr. 8, datë 6.8.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,
PËR PËRPILIMIN E LISTAVE,
MËNYRËN E HARTIMIT TË SKEDAVE
PËRSHKRUESE PËR PASURITË E
PALUAJTSHME NË PRONËSI
SHTETËRORE, OBJEKT VERIFIKIMI
TË INTERESIT KULTUROR, DHE
DËRGIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 58, pika 2, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar,



UDHËZOJ:

Neni 1

Objekti

Ky udhëzim përcakton:

a) kriteret për përpilimin e listave të pasurive të paluajtshme në pronësi shtetërore që do t'i nënshtrohen procesit të verifikimit të interesit kulturor;

b) mënyrën e hartimit dhe përmbajtjen e skedave përshkruese të këtyre pasurive;

c) mënyrën dhe dokumentacionin për dërgimin e listave dhe skedave përshkruese pranë institucioneve kompetente.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore, të cilat i nënshtrohen procedurës së verifikimit të interesit kulturor, sipas nenit 57, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

Neni 3

Parimet e dokumentimit

1. Dokumentimi i pasurive të paluajtshme, objekt verifikimi, realizohet në mënyrë të unifikuar, të standardizuar dhe të verifikueshëm.

2. Të dhënat e dokumentuara, duhet të sigurojnë:

a) identifikimin e saktë të pasurisë;

b) gjurmueshmërinë administrative dhe territoriale;

c) krahasueshmërinë e informacionit ndërmjet pasurive;

ç) mbështetjen e procesit të verifikimit të interesit kulturor;

d) integrimin e të dhënave në sistemet shtetërore të administrimit të trashëgimisë kulturore.

3. Struktura dhe përmbajtja e listave dhe skedave përshkruese përcaktohen në anekset që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 4

Kriteret për përpilimin e listave

Në listat e pasurive të paluajtshme në pronësi shtetërore përfshihen pasuritë që plotësojnë një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

a) janë ndërtuar ose krijuar më shumë se 70 vjet para datës së hartimit të listës;

b) paraqesin indicie për vlera historike, artistike, arkitektonike, arkeologjike ose etnografike;

c) evidentohen në dokumentacion historik, arkivor, bibliografik ose hartografik;

ç) janë pjesë e qendrave historike, ansambleve historike, peizazheve kulturore ose zonave arkeologjike;

d) janë identifikuar ose propozuar nga institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, autoritetet publike administruese, njësitë e vetëqeverisjes vendore, komuniteti lokal ose organizatat e shoqërisë civile, në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

Neni 5

Përgatitja e listave

1. Listat e pasurive të paluajtshme në pronësi shtetërore, objekt verifikimi të interesit kulturor, hartohen nga institucioni që administron pasurinë, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, sipas kompetencës territoriale dhe funksionale.

2. Për pasuritë e paluajtshme në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, listat hartohen nga strukturat përkatëse të saj.

3. Lista hartohet mbi bazën e dokumentacionit administrativ, teknik, kadastral, historik dhe informacionit të mbledhur gjatë verifikimeve në terren.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e listave

1. Listat e pasurive të paluajtshme në pronësi shtetërore, objekt verifikimi të interesit kulturor, hartohen sipas modelit të përcaktuar në aneksin I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Lista përmban të paktën këto të dhëna:



- a) emërtimin e pasurisë;
- b) vendndodhjen dhe koordinatat gjeografike sipas Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare;
- c) të dhënat e identifikimit kadastral, kur disponohen;
- ç) institucionin administrues;
- d) përshkrimin e shkurtër të karakteristikave kryesore;
- dh) të dhëna paraprake mbi vlerat e mundshme historike, artistike, arkitektonike, arkeologjike ose etnografike;
- e) të dhëna mbi gjendjen fizike dhe funksionale;
- ë) të dhëna mbi statusin e mbrojtjes dhe dokumentet përkatëse, kur disponohen;
- f) të dhëna mbi aksesin dhe përdorimin;
- g) dokumentacionin mbështetës të disponueshëm.

3. Lista hartohet në format elektronik dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi për arkivat dhe administrimin e dokumenteve.

Neni 7

Hartimi i skedave përshkruese

1. Për çdo pasuri të përfshirë në listë hartohet një skedë përshkruese sipas modelit të përcaktuar në aneksin II.

2. Skeda përshkruese hartohet mbi bazën, e:

- a) verifikimit në terren;
- b) dokumentacionit teknik dhe kadastral;
- c) dokumentacionit historik dhe arkivor;
- ç) dokumentacionit fotografik dhe hartografik;
- d) burimeve të tjera dokumentare të disponueshme.

3. Skeda përshkruese duhet të përmbajë të dhëna të plota, të sakta dhe të përditësuara.

4. Skeda përshkruese nënshkruhet nga personi përgjegjës për hartimin e saj dhe miratohet nga institucioni që e paraqet.

Neni 8

Përmbajtja e skedës përshkruese

1. Skeda përshkruese përmban të dhëna administrative, juridike, teknike, historike, arkitektonike, konstruktive, fotografike dhe hartografike, si dhe informacion mbi gjendjen e konservimit dhe vlerësimin e riskut.

2. Fushat e detyrueshme dhe mënyra e plotësimit të tyre përcaktohen në aneksin II.

3. Çdo ndryshim në modelin standard të skedës bëhet me ndryshimin e këtij udhëzimi.

Neni 9

Dërgimi i listave dhe skedave përshkruese

1. Institucioni administrues i pasurisë harton listën e pasurive dhe skedat përshkruese sipas kërkesave të këtij udhëzimi dhe i dërgon pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

2. Dokumentacioni dërgohet në format elektronik dhe, kur kërkohet, edhe në format fizik.

3. Dokumentacioni përfshin:

- a) listën e pasurive;
- b) skedat përshkruese;
- c) dokumentacionin fotografik;
- ç) dokumentacionin hartografik;
- d) dokumentacionin kadastral, kur disponohet;
- dh) dokumente të tjera mbështetëse.

4. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, brenda 15 ditëve pune nga marrja e dokumentacionit, verifikon plotësinë dhe përputhshmërinë e tij me kërkesat e këtij udhëzimi.

5. Kur dokumentacioni rezulton i paplotë ose përmban pasaktësi, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore i kërkon institucionit administrues plotësimin ose korrigjimin e tij, duke përcaktuar elementet që duhet të plotësohen dhe afatin për paraqitjen e dokumentacionit plotësues, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 20 (njëzet) ditë pune nga data e marrjes së njoftimit.

6. Me kërkesë të arsyetuar të institucionit administrues, kur plotësimi i dokumentacionit kërkon marrjen e të dhënave nga institucione të tjera, kryerjen e verifikimeve teknike në terren, përgatitjen e dokumentacionit shtesë ose për arsye të tjera objektive, afati i përcaktuar në pikën 5 të këtij neni mund të shtyhet edhe me 10 (dhjetë) ditë pune të tjera.

7. Afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni pezullohet nga data e njoftimit për plotësimin e dokumentacionit dhe rifillon me paraqitjen e dokumentacionit të plotësuar.

8. Në rast se institucioni administrues nuk paraqet dokumentacionin e plotësuar brenda afatit të përcaktuar sipas këtij neni, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore njofton me shkrim institucionin administrues për mbylljen e



procedurës së verifikimit të dokumentacionit. Paraqitja e mëvonshme e dokumentacionit trajtohet si kërkesë e re dhe i nënshtrohet procedurës së parashikuar në këtë udhëzim.

9. Pas miratimit të procedurës së verifikimit të interesit kulturor dhe deklarimit të objektit pasuri kulturore nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore përcjell dokumentacionin e plotë (kartelën teknike dhe urdhrin e ministrit) pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e objektit në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore”.

10. Dokumentacioni konsiderohet i plotë kur përmban elementet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni dhe është përgatitur sipas anekseve të këtij udhëzimi.

11. Deklarimi i një pasurie të paluajtshme shtetërore si pasuri kulturore nuk sjell ndryshimin e pronësisë ose të institucionit administrues të saj. Pasuria vijon të administrohet nga institucioni që e ka në administrim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e pronës publike dhe me detyrimet, kufizimet dhe kërkesat që rrjedhin nga statusi i saj si pasuri kulturore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

Neni 10

Administrimi i të dhënave

1. Të dhënat e përfshira në listat dhe skedat përshkruese administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat teknike të institucioneve përgjegjëse të trashëgimisë kulturore.

ANEKS I

2. Të dhënat mund të përdoren për dokumentimin, monitorimin, studimin dhe administrimin e pasurive objekt verifikimi të interesit kulturor.

3. Në zbatim të nenit 32, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, pasuritë kulturore të deklaruar regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore (RKPK), i cili administrohet nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

Neni 11

Autoritetet zbatuese

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet shtetërore që administrojnë pasuri të paluajtshme në pronësi shtetërore objekt verifikimi të interesit kulturor.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME NË PRONËSI SHETËRORE OBJEKT VERIFIKIMI TË INTERESIT KULTUROR

Nr.	Emërtimi i pasurisë	Monument (kategoria I/II)	Kodë RKPK	Viti i përfshirë i ndërtimit	Institucioni administrues në varësi të MTKS	Pronësia (shtetërore/qendrore/ve ndore)	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Vendodhja (qark/bashki/njësi administrative/fshati)	Marrëdhënia me hapësirën urbane (qendër historike/ansambël historik urban/arkitektonik/ zonë arkeologjike)	Gjendja e pasurisë kulturore 1-5 1 = shumë të mirë 2 = e mirë 3 = e demtuar 4 = e keqe, e rëndë 5 = shumë e rëndë	Funksioni aktual	Komente
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14



ANEKS II

SKEDA PËRSHKRUESE (KARTELA) nr. _____						
PËR PASURITË KULTURORE MATERIALE TË PALUAJTSHME						
1. TË DHËNA ADMINISTRATIVE TË PASURISË KULTURORE						
1.1 Kodi i arkivës IKTK						
1.2 Kod RKPK (<i>kodi unik i objektit të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore</i>)						
1.3 Emërtimi/kodi sipas zonifikimit, nëse ka	<i>Emërtimi sipas aktit të shpalljes në fuqi/ kodi sipas zonifikimit nëse ka</i>					
1.4 Kategoria						
1.4.1 Fusha						
1.4.2 Teknika						
1.4.3 Tipologjia						
1.5 Statusi i mbrojtjes						
1.5.1 Rëndësia e vlerave	Me rëndësi universale (kriteri-et); <i>Me rëndësi kombëtare (kriteri-et);</i> Me rëndësi lokale (kriteri-et); <i>Me rëndësi për ansamblin (kriteri-et).</i>					
1.6 Data e shpalljes						
1.6.1 Shpallja	Lloji i aktit ligjor	Numri	Institucioni i shpalljes			
1.7 Datimi (viti/shek.)						
1.8 Institucioni administrues në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore						
1.8.1 Vendndodhja	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Fshati	Adresa	Adresa alternative
1.8.2 Koordinatat gjeografike të monumentit	<i>Gjerësi dhe gjatësi gjeografike sipas sistemit KRRGJSH</i>					
1.8.3 Pamje të pozicionit në hartë	<i>Vendosjes e një imazhi harte ose direkt përmes Google Maps, pikë dhe poligon i ndërtesës</i>					
1.8.4 Zonë mbrojtëse të pasurisë kulturore	<i>“Po”, “Jo”</i>					
1.8.5 Koordinata gjeografike të zonës mbrojtëse						
1.8.6 Zona kadastrale						
1.8.7 Nr. i pasurisë dhe sipërfaqe						



1.9 Të dhëna sasiore	Lartësia e objektit (m)	Nr. i kateve	Sipërfaqja e ndërtimit (m ² /ha)	Sipërfaqja e përgj. e rrethimit (m ² /ha)	Sipërfaqja e zonës mbrojtëse (m ² /ha)
1.10 Akses i deri në monument?	☐ Rrugë automobilistike ☐ Rrugë këmbësore				
1.10.1 Gjendja e rrugës	☐ E mirë ☐ E keqe				

2. TË DHËNA RRETH PRONËSISË

2.1 Pronësia	<i>“Shtetërore”, “Private”</i>
2.1.1 Emri i pronarit (-ve)	

3. TË DHËNA TEKNIKE

3.1 Historiku i objektit	<i>Interesi: historik/artistik/arkitektonik/arkelogjik/etnografik</i>
3.2 Përshkrimi arkitektonik	
3.2.1 Marrëdhënia me hapësirën urbane	<i>Funksioni i pasurive kulturore në raport me hapësirën ku ndodhen qoftë qendër historike, ansambël historik urban, arkitektonik, zonë arkeologjike etj.</i>
3.2.2 Autorësia	<i>Autor grupin e projektimit/pa autor</i>

4. KONSERVIM/RESTAURIM/MIRËMBAJTJE

4.1 Viti i ndërhyrjes	<i>1, 2,....</i>
4.1.1 Lloji i ndërhyrjes	<i>lloji i ndërhyrjes të jetë i lidhur me çdo vit të ndërhyrjes më sipër.</i>

5. PËRSHKRIMI KONSTRUKTIV –

5.1 Pasuria kulturore	Ekziston Nuk ka gjurmë të ndërtesës pasuri kulturore
5.2 Gjendja ndërtim/rënoje arkeologjike	<i>Ndërtim Rënoje arkeologjike</i>
5.3 Skema strukturore	
5.4 Materiali i ndërtimit	
5.5 Elementet konstruktive	
5.5.1 Themelet	
5.5.2 Skema e mbulimit	
5.5.3 Materiali i mbulimit	



5.5.4 Të tjera (dyer, dritare, shkallë, porta hyrëse, tavane, dysHEME etj.)	
5.5 Elemente të paluajtshme (vepra arti/pjesë përbërëse e pasurisë)	
6. ELEMENTE TË TJERA ARKITEKTONIKE	
6.1 Elemente të paluajtshme (vepra arti)	- pikturë murale; - objekteve në dru të gdhendur, dru të dekoruar, stukoreliev; - mozaik; - dekorime metali.
7. DOKUMENTACIONE DHE ARKIVA	
7.1 Dokumentacioni grafik dhe hartografik	
7.2 Dokumentacioni fotografik	
7.3 Dokumentacioni referencë/bibliografi	<i>Bibliografia</i>
8. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME GJATË REALIZIMIT TË MONITORIMIT TË GJENDJES SË KONSERVIMIT DHE VLERËSIMIN POTENCIAL TË RISKUT	
8.1 Aksesi	☐ I aksesueshëm; ☐ I aksesueshëm me vështirësi; ☐ I paaksesueshëm.
8.2 Rreziku mbizotërues	☐ Tërmet; ☐ Përmytje; ☐ Rrëshqitje; ☐ Zjarri; ☐ Risk biologjik, sëmundje infektive; ☐ Ortekë; ☐ Ndryshim klimaterik; ☐ Tjetër, specifiko.
8.3 Përdorimi	☐ Në përdorim; ☐ Shfrytëzim ose përdorim i pjesshëm; ☐ Jo në përdorim.
8.4 Objekte të tjetërsuara, për vlerat për të cilat është shpallur pasuri kulturore	<i>PO/JO (nëse "po" shpjego)</i>
8.5 Përdorimi/funksioni fillestar	
8.6 Funksioni aktual	
8.7 Të dhënat e personit të kontaktit	
8.7.1 Email-i	
8.7.2 Mob./Tel.	
8.7.3 Shënime	

**9. MATRICA E GJENDJES SË RISKUT**

Gjendja strukturore			Vlerësimi i gjendjes	Klasifikimi rrezikshmërisë	i
Objekte plotësisht të shkatërruara (e përdorshme)			• Ndërtesë e shkatërruar jashtë funksionit; • Shkatërrim i plotë i strukturave horizontale/rrëzim (specifiko elementet dhe ambientin) plotë/pjesor i strukturave vertikale.	4	
Objekte në rrezik qëndrueshmërie (pjesërisht e përdorshme/ e përdorshme)			• Shkatërrim pjesor/rrëzim (specifiko elementet dhe ambientin); • Çarjet e mëparshme janë thelluar të gjitha; • Humbje e dukshme e vertikalitetit (specifiko elementet); • Dëmtim i përqendruar (specifiko elementin/ambientin); • Dëmtim i konsiderueshëm i elementeve strukturore (çarje të thella, armatura në b/a e dukshme etj.).	3	
Ndërtesa nuk duhet të përdoret në mënyrë të vazhdueshme/nevojë restaurimi (përkohësisht e përdorshme)			• Çarjet e mëparshme janë thelluar të gjitha; • Humbje e dukshme e vertikalitetit (specifiko elementet); • Dëmtim i përqendruar (specifiko elementin/ambientin); • Dëmtim mesatar i elementeve strukturore (çarje të dukshme).	2	
Objekte në gjendje të mirë; në nevojë mirëmbajtjeje të vazhdueshme (E përdorshme – pa rrezik)			• Dëmtime sipërfaqësore në suva (specifiko spesorin e çarjeve dhe ambientin); • Dëmtim i lehtë i elementeve strukturore (çarje deri 2 mm).	1	

10. TË DHËNAT E SKEDIMIT

10.1 Skeduesi:	
10.2 Titulli/profesionit i skeduesit:	
10.3 Data e plotësimit:	
10.4 Data e përditësimit:	



URDHËR

Nr. 163, datë 14.8.2026

**PËR USHTRIMIN E KOMPETENCAVE
DHE DETYRAVE TË DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMIT TË
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE
SHPËTIMIN**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Z. Ervis Gjoshi, me gradën Kryekomisar, caktohet të ushtrojë kompetencat dhe detyrat e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në lidhje me funksionimin administrativ dhe drejtimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse në fushën e përgjegjësisë së MZSH-së.

2. Në ushtrimin e detyrave të përkohshme, siguron vazhdimësinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së dhe ushtron kompetencat e nevojshme për garantimin e funksionimit normal të saj, në kufijtë e kompetencave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

3. Ky urdhër qëndron në fuqi deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të MZSH-së ose deri në shfuqizimin e tij.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

URDHËR

Nr. 806, datë 7.8.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SPANJËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70 °C në 3.6 sekonda;

iii. 74 °C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas tabelës së mëposhtme:



Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Castello de Rugat*
2.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Ontinyent*
3.	Castilla y León	Valladolid	Valladolid*
4.	Castilla y León	Valladolid	Olmedo*
5.	Castilla y León	Valladolid	Medina del Campo*
6.	Castilla y León	Valladolid	Peñafiel*
7.	Castilla y León	Valladolid	Tordesillas*
8.	Castilla y León	Zamora	Toro*
9.	Castilla y León	Segovia	Cuellar*
10.	Castilla y León	Ávila	San Pedro del Arroyo*
11.	Castilla y León	Salamanca	Peñaranda de Bracamonte*
12.	Castilla y León	Segovia	Santa Maria la Real de Nieva*
13.	Castilla y León	ÁVILA	AREVALO*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Spanjës, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të

shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 793, datë 3.8.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

URDHËR
Nr. 816, datë 11.8.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe



ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Somogy	Barcs*	
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Mátészalka*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Hungarisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve, është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;



b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

c) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.



4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 616, datë 5.6.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Hungarisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

URDHËR
Nr. 817, datë 11.8.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
RUMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen

dhe dhi, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e pikës 2.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Mureş	Voivodeni*
2.	Mureş	Vatava*
3.	Mureş	Zau De Campie*
4.	Mureş	Suseni*
5.	Buzău	Padina*
6.	Iaşi	Popesti*
7.	Tulcea	Murighiol*
8.	Vâlcea	Malaia*
9.	Gorj	Turcineşti*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 808, datë 10.8.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika**

**URDHËR
Nr. 818, datë 11.8.2026**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHETËTIN E SPANJËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë*
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavía*
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicía	A Coruña	Ferrol*

Galicía	A Coruña	A Barcala*
Galicía	Lugo	Meira*
La Rioja	La Rioja	Alfaro*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha



stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antittrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antittrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 764, datë 24.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika



URDHËR

Nr. 819, datë 11.8.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË MBRETËRINË
E BASHKUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
England	Barnsley	Barnsley*
England	Bath and North East Somerset	Bath and North East Somerset*
England	Buckinghamshire	Buckinghamshire*
England	Bournemouth, Christchurch and Poole	Bournemouth, Christchurch and Poole*
England	Bracknell Forest	Bracknell Forest*
England	Bradford	Bradford*
England	Bury	Bury*
England	Calderdale	Calderdale*
England	Cambridgeshire	East Cambridgeshire*
England	Cambridgeshire	South Cambridgeshire*
England	Central Bedfordshire	Central Bedfordshire*
England	Cheshire East	Cheshire East*
England	Cheshire West and Chester	Cheshire West and Chester*
England	Cornwall	Cornwall*

England	Cumberland	Cumberland Council*
England	Derbyshire	Amber Valley*
England	Derbyshire	Bolsover*
England	Derbyshire	Derbyshire Dales*
England	Derbyshire	High Peak*
England	Derbyshire	South Derbyshire*
England	Derbyshire	North East Derbyshire*
England	Devon	East Devon*
England	Devon	Mid Devon*
England	Devon	North Devon*
England	Devon	Torridge*
England	Devon	Teignbridge*
England	Devon	South Hams*
England	Devon	West Devon*
England	Dorset	Dorset*
England	Doncaster	Doncaster*
England	Gloucestershire	Stroud*
England	Gloucestershire	Cotswold*
England	East Riding of Yorkshire	East Riding of Yorkshire*
England	East Sussex	Rother*
England	East Sussex	Lewes*
England	East Sussex	Wealden*
England	Essex	Braintree*
England	Essex	Brentwood*
England	Essex	Chelmsford*
England	Essex	Colchester*
England	Essex	Epping Forest*
England	Essex	Maldon*
England	Essex	Harlow*
England	Essex	Tendring*
England	Greater London	Harrow*
England	Herefordshire, County of	Herefordshire, County of*
England	Hertfordshire	Dacorum*
England	Hertfordshire	East Hertfordshire*
England	Hertfordshire	Hertsmere*
England	Hertfordshire	Three Rivers*
England	Medway	Medway*



England	Milton Keynes	Milton Keynes*
England	Shropshire	Shropshire*
England	Kent	Ashford*
England	Kent	Canterbury*
England	Kent	Dover*
England	Kent	Gravesham*
England	Kent	Folkestone and Hythe*
England	Kent	Maidstone*
England	Kent	Sevenoaks*
England	Kent	Swale*
England	Kent	Tonbridge and Malling*
England	Kent	Tunbridge Wells*
England	Kirklees	Kirklees*
England	Isle of Wight	Isle of Wight*
England	Somerset	Somerset Council*
England	Suffolk	East Suffolk*
England	Suffolk	Babergh*
England	Suffolk	Mid Suffolk*
England	Suffolk	Waverley*
England	Suffolk	West Suffolk*
England	Surrey	Guildford*
England	Surrey	Runnymede*
England	Hampshire	Basingstoke and Deane*
England	Hampshire	East Hampshire*
England	Hampshire	Eastleigh*
England	Hampshire	Hart*
England	Hampshire	Test Valley*
England	Hampshire	New Forest*
England	Hampshire	Winchester*
England	Lancashire	Chorley*
England	Lancashire	Hyndburn*
England	Lancashire	Lancaster*
England	Lancashire	Ribble Valley*
England	Lancashire	Wyre*
England	Leicestershire	Charnwood*
England	Leicestershire	Harborough*
England	Leicestershire	Hinckley and Bosworth*
England	Leicestershire	North Leicestershire West*
England	Lincolnshire	East Lindsey*
England	Lincolnshire	West Lindsey*
England	Lincolnshire	South Kesteven*

England	Staffordshire	East Staffordshire*
England	Staffordshire	Newcastle-under-Lyme*
England	Staffordshire	Stafford*
England	Staffordshire	Staffordshire Moorlands*
England	Staffordshire	South Staffordshire*
England	Southampton	Southampton*
England	South Gloucestershire	South Gloucestershire*
England	Stockport	Stockport*
England	Norfolk	Breckland*
England	Norfolk	Broadland*
England	Norfolk	Great Yarmouth*
England	Norfolk	King's Lynn and West Norfolk*
England	Norfolk	South Norfolk*
England	Norfolk	North Norfolk*
England	North Yorkshire	North Yorkshire Council*
England	Nottinghamshire	Bassetlaw*
England	Nottinghamshire	Newark and Sherwood*
England	Oxfordshire	South Oxfordshire*
England	Oxfordshire	Vale of White Horse*
England	Tameside	Tameside*
England	Trafford	Trafford*
England	Thurrock	Thurrock*
England	York	York*
England	West Berkshire	West Berkshire*
England	Wiltshire	Wiltshire*
England	Wokingham	Wokingham*
England	Westmorland and Furness Council	Westmorland and Furness Council*
England	West Sussex	Arun*
England	West Sussex	Chichester*
England	West Sussex	Horsham*
England	West Sussex	Mid Sussex*
Isle of Man	Glenfaba	Patrick*
Isle of Man	Middle	Braddan*
Isle of Man	Rushen	Arbory*
Isle of Man	Rushen	Rushen*
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Brightlingsea*	
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Middleton*	
Wales	Ceredigion	Ceredigion*



Wales	Denbighshire	Denbighshire*
Wales	Monmouthshire	Monmouthshire*
Wales	Powys	Powys*
Wales	Wrexham	Wrexham*
Northern Ireland	North Down and Ards	Ards*
Northern Ireland	Ards and North Down	North Down*
England	Wakefield	Wakefield*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një

programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë



në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 750, datë 20.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

¹ Ky urdhër përaftron Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/2154, e 14 tetorit 2020, që plotëson Rregulloren (BE) 2016/429 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me

URDHËR¹

Nr. 821, datë 11.8.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT E SHËNDETIT TË KAFSHËVE, CERTIFIKIMIT DHE NJOFTIMIT PËR LËVIZJET E PRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE NGA KAFSHËT TOKËSORE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 166, të pikës 3, të nenit 168 dhe të pikës 5, të nenit 169, të ligjit nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat e shëndetit të kafshëve, certifikimit dhe njoftimit për lëvizjet e produkteve me origjinë shtazore nga kafshët tokësore”, sipas tekstit pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen, sipas fushës së përgjegjësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe zbatohet nga data 1 gusht 2027.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

RREGULLORE

PËR KËRKESAT E SHËNDETIT TË KAFSHËVE, CERTIFIKIMIT DHE NJOFTIMIT PËR LËVIZJET E PRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE NGA KAFSHËT TOKËSORE

Neni 1
Objekti dhe fusha zbatimit

Ky urdhër plotëson rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”, në

shëndetin e kafshëve, kërkesat e certifikimit dhe njoftimit për lëvizjet brenda Bashkimit të produkteve me origjinë shtazore nga kafshët tokësore, nr. i dokumentit 32020R2154.



lidhje me lëvizjet e ngarkesave të produkteve me origjinë shtazore nga kafshët tokësore, në lidhje me:

a) detyrimet mbi operatorët për lëvizjet e ngarkesave të produkteve me origjinë shtazore nga kafshët tokësore të prodhuara ose të përpunuara në stabilimente, biznese ushqimore ose zona që i nënshtrohen masave emergjente ose kufizimeve të lëvizjes, siç përmendet në pikën 2, të nenit 166, të ligjit nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”;

b) kërkesat e informacionit për certifikatën e shëndetit të kafshëve të parashikuara në pikën 1, të nenit 167, “duke ju referuar certifikimit të shëndetit të kafshëve”, të ligjit nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”;

c) kërkesat e informacionit për njoftimin paraprak të lëvizjeve të këtyre ngarkesave në shtete të tjera, të parashikuara në pikën 1, të nenit 169 “duke ju referuar njoftimit paraprak” të ligjit nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”;

ç) procedurat e emergjencës për njoftimin paraprak të lëvizjeve së këtyre ngarkesave, të parashikuara në pikën 1, të nenit 169, të ligjit nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”, në rast të ndërprerjeve të energjisë elektrike dhe problematikave të tjera të *TRACES*.

Neni 2

Detyrimet për operatorët që lëvizin ngarkesat e produkteve me origjinë shtazore

Operatorët lëvizin ngarkesat e produkteve me origjinë shtazore nga kafshët tokësore që i nënshtrohen masave të emergjencës ose kufizimeve të lëvizjes të përmendura në pikën 2, të nenit 166, të ligjit nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”, vetëm nëse:

a) lëvizje të tilla autorizohen nga autoriteti kompetent i vendit të origjinës; dhe

b) ngarkesat përputhen me kushtet për autorizimin e kërkuar në përputhje me shkronjën “a”.

Neni 3

Certifikata e shëndetit të kafshëve për lëvizjen e ngarkesave të produkteve me origjinë shtazore

Përveç informacionit të kërkuar në përputhje me pikën 1, të nenit 168, të ligjit nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”, certifikata e shëndetit të

kafshëve duhet të përmbajë dhe informacionin e përcaktuar në shtojcën e këtij urdhri.

Neni 4

Detyrimi i operatorëve për dhënien e informacionit në njoftimin paraprak të lëvizjeve së ngarkesave të produkteve me origjinë shtazore

Përveç informacionit të kërkuar në përputhje me pikën 1, të nenit 168, të ligjit nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”, në njoftimin paraprak, operatorët i japin autoritetit kompetent edhe informacionin e përcaktuar në shtojcë, për çdo ngarkesë të produkteve me origjinë shtazore të përmendura në nenin 1 të këtij urdhri.

Neni 5

Procedurat e emergjencës

Në rast të ndërprerjeve të energjisë elektrike ose problematikave të tjera të *TRACES*, autoriteti kompetent i vendit të origjinës duhet të përmbushë procedurat e emergjencës për *TRACES*, në rast të padisponueshmërisë së paplanifikuar ose të planifikuar të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Kontrollin Zyrtarë (IMSOC), për ngarkesat e produkteve me origjinë shtazore të përmendura në nenin 1 të këtij urdhri, të cilat do të lëvizin në një shtet tjetër.

SHTOJCA

Informacioni që duhet të përmbahet në certifikatën shëndetësore të kafshëve që shoqëron lëvizjet e ngarkesave të produkteve me origjinë shtazore nga kafshët tokësore

a) emrin dhe adresën e dërguesit dhe të marrësit;
b) emrin dhe adresën e stabilimentit ose të vendit të dërgimit;

c) emrin dhe adresën e stabilimentit ose të vendit të destinacionit;

ç) një përshkrim të produktit me origjinë shtazore, duke përfshirë: i. kategorinë e produktit, siç përcaktohet në nenin 2 të urdhrit “Për miratimin e rregullores ‘Për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të listuara’”:

- mish i freskët “duke specifikuar kategorinë, nëse është e nevojshme”;
- produktet e mishit;



- zorrët;
- qumësht i papërpunuar, kulloshtre dhe produkte me bazë kulloshtre;
- produkte qumështi;
- vezë;
- produkte vezësh;
- produkte të përbëra “që tregojnë përbërës me origjinë shtazore”;
- ii. speciet e kafshëve nga të cilat është marrë produkti me origjinë shtazore;
- iii. vendi ose rajoni i origjinës së lëndës së parë;
- iv. trajtimi/trajtimet që i janë nënshtruar produktit me origjinë shtazore;
- v. shënjimit të aplikuar në produktin me origjinë shtazore, kur kërkohet;
- vi. vendin dhe datën e prodhimit ose përpunimit të tyre;
- d) sasia e produktit me origjinë shtazore;
- dh) datën dhe vendin e lëshimit të certifikatës shëndetësore të kafshëve. Emrin, funksionin dhe firmën e veterinerit zyrtar dhe vulën e autoritetit kompetent të vendit të origjinës së ngarkesës;
- e) emri i sëmundjes së listuar ose sëmundjes emergjente që shkakton kufizime të lëvizjes në stabilimentin, biznesin ushqimor ose zonën në vendin e dërgimit;
- ë) detajet e përputhshmërisë me kushtet për dhënien e autorizimit të përmendur në nenin 2 të këtij urdhri; dhe ose:
- i. titullin, numrin, datën dhe datën e botimit në Fletoren Zyrtare të aktit përkatës që përcakton kushtet për dhënien e autorizimit; ose
- ii. referencën e plotë të aktit ose udhëzimit përkatës, të miratuar dhe të bërë publik nga autoriteti kompetent, në të cilin përcaktohen këto kushte.

URDHËR

Nr. 822, datë 12.8.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë*
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Castilla y León	Segovia	Segovia*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavía*
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicía	A Coruña	Ferrol*
Galicía	A Coruña	A Barcala*
Galicía	Lugo	Meira*
La Rioja	La Rioja	Alfaro*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me



nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo

28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinarë shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe



embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 818, datë 11.8.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Gjuhës Blu të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË]]Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 182|Datë: 17.08.2026 13:15:36
+02:00|9d7f1c4f-8b46-42fa-8701-532b9936adb2

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)